

Dokumentacioni shoqërues

Për të mundësuar trajtimin e kërkesës suaj, formularit të kërkesës për Raport Kredimarrësi, lutemi t'i bashkëlidhni dhe dokumentacionin si në vijim:

A. Kur kërkesa i referohet pajisjes me Raportin e Kredimarrësit si **“INDIVID”**:

1. Një kopje e dokumentit të identifikimit të subjektit të të dhënave (kredimarrësit), si dhe një dokument brenda afatit të vlefshmërisë së tij, që të përmbajë edhe *atësinë e* subjektit të të dhënave (të tillë si certifikata familjare/personale etj.);
2. Në rast se kërkesa dorëzohet nga një person i autorizuar nga subjekti i të dhënave, atëherë përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 1 më lart, nevojitet të dorëzohet gjithashtu :
 - a. një prokurë origjinale, i lëshuar nga subjekti i të dhënave për personin e autorizuar, si dhe
 - b. një kopje e dokumentit të identifikimit të këtij të fundit.

B. Kur kërkesa i referohet pajisjes me Raportin e Kredimarrësit si **“Subjekt Tregtar”**:

1. Një kopje e “Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar” ose origjinali i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
2. Një kopje e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor/administratorit të shoqërisë që paraqet kërkesën në emër të kësaj të fundit;
3. Në rast se kërkesa paraqitet nga një person i autorizuar nga subjekti i të dhënave, asaj i bashkëngjitet dhe një prokurë origjinale apo autorizim i posaçëm, i lëshuar nga subjekti i të dhënave për personin e autorizuar, si dhe një kopje e dokumentit të identifikimit të këtij të fundit;
4. Mandat pagesa me të dhënat si në vijim:
 - Përshkrimi Për sa derdhur/urdhëruar nga (përfaqësuesi ligjor “Emri i subjektit Tregtar”, tarifa për nxjerrje të Raportit të Kredimarrësit nga Regjistri i Kredive”;
 - Shuma e pagesës 500 ALL
 - Banka përfituese Banka e Shqipërisë (Kodi BIC- STANALTR)
 - Llogaria përfituese (IBAN AL88 1011 1008 0000 0000 7777 777L)
Regjistri i Kredive, BSH